



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 18/15

Prishtinë, më 13.5.2015, ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjonaj, Latif Gashi, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta, Ilir Deda, Bali Muharremaj, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Mungoi: Bojan Mitić.

Pjesëmarrës të ftuar: Lulzim Rafuna-Drejtor i Doganës, Behxhet Haliti – Drejtor i ATK-së, Agim Krasniqi - zv. Ministër i Financave, Lavdin Krasniqi - Drejtor i IGJK, Suzana Pllana – Drejtoresh e Administratës në IGJK.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Alexandra Fehlinger, Ramadan Islami dhe Rejhane Zylfijaj nga GIZ, Monitorues nga Zyra e Presidencës, nga monitorues nga GAP, KTV, BIRN, OSBE.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli dhe Merita Zogjani (Praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetari i Komisionit.

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 22.4.2015 29.4.2015 dhe 6.5.2015;**
- 3. Takimi me Doganat e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës, në kuadër të procesit të monitorimit të realizimit të planit të të hyrave për tremujorin e parë të vitit 2015;**
- 4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Tatimin në të Ardhurat Personale;**
- 5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave;**
- 6. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Instituti Gjyqësor të Kosovës për vitin 2014;**
- 7. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – konstatoj se komisioni njëzëri miratoi rendin e ditës.

**2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 22.4.2015
29.4.2015 dhe 6.5.2015**

Kryetari – konstatoj se komisioni miratoi procesverbalet pa vërejtje.

3. Takimi me Doganat e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës, në kuadër të procesit të monitorimit të realizimin e planit të të hyrave për tremujorin e parë të vitit 2015

3.1. Takimi me Doganat e Kosovës, në kuadër të procesit të monitorimit të realizimin e planit të të hyrave për tremujorin e parë të vitit 2015

Kryetari – ne kemi planifikuar që në baza tremujore të takohemi me drejtuesit e dy agjencioneve kryesore që merren me mbledhjen e të hyrave buxhetore siç janë Doganat dhe ATK, për të diskutuar në lidhje me planifikimin dhe nivelin real të realizimit të planit të të hyrave, sfidat dhe vështirësitë e identifikuar në këtë proces përfshirë edhe sfidat e bizneseve. Gjatë takimit presim informata dhe të dhëna për punën e tyre, për të arriturat, ngeçjet dhe vështirësitë, në përmbushjen e planit aktual dhe planifikimeve duke marrë parasysh edhe ndryshimet ligjore si rezultat i reformës fiskale, marrëveshjeve për tregti të lirë dhe procesin e zbatimit MSA-së dhe ndikimin e këtyre në të hyrat buxhetore në vazhdim.

Lulzim Rafuna – informojë se në vitin 2014 filluam me një reformë shumë të thellë brenda Doganës për arsye se e kemi pas një hierarki të centralizuar që është trashëguar nga viti 2003 gjatë kohës së UNMIK-ut. Fal këtij angazhimi ne filluam me rezultat e para në të hyra po edhe një mbikëqyrje më të mirë dhe duke ofruar shërbime më të mira biznesit. Dogana e Kosovës në periudhën Janar – Mars 2015 për shkak të disa faktorëve të cilët nuk kanë qenë në domenin tonë kemi pas një sasi të mallrave prej 12.61% më pak krahasuar me periudhën e njëjte të vitit 2014. Përkundër rënies së sasisë ne kemi arrit që të kemi të hyra për 2% më shumë se në vitin e kaluar. Këto të dhëna dëshmojnë masat që janë marrë për të luftuar, evazionin fiskal dhe korrupsionin duke ngrit disiplinën brenda Doganës. Nëse e konsiderojmë historinë e të hyrave gjatë viteve është evidentuar se në vitin 2014 janë mbledhur më së shumti të hyra në Doganën e Kosovës në shumë prej 871.8 milion, përkundër rënies së sasisë së mallrave prej 5% krahasuar me vitin 2013. Dogana e Kosovës është e llojit të veçantë në rajon se përveç që mbledhim të hyra, kemi përgjegjësit edhe në fushën e sundimit të ligjit për të luftuar korrupsionin, kontrabandën dhe evazionin fiskal bashkë me të gjitha institucionet tjera si policia. Gjatë tre muajve të parë ne kemi shqyrtuar 263 kundërvajtje doganore, ndërsa kemi proceduar në Prokurori 30 kallëzime penale, gjersa në vitin 2014 janë shqyrtuar 339 kundërvajtje doganore, ndërsa janë proceduar 31 kallëzime penale. Përveç këtyre fushave ne kemi edhe masat e lehtësimit në mënyrë që bizneset të kenë qarkullim më të lehtë të mallit në për mjet pikave kufitare. Agjencionet ndërkombëtare na kanë mundësuar që të ndërtojmë një sistem selektiviteti. Me këtë sistem 90% e maunave që kalojnë ose mallrave që vijnë në Kosovë bëhet vetëm ekzaminimi dokumenteve e jo ekzaminimi fizik, ndërsa 10% e tyre i nënshtrohen ekzaminimit detal të mallrave. Mirëpo konsiderojmë që nevojitet ende kohë për të ulë këtë përqindje. Në këtë vit i kemi lejuar 8 autorizime doganore për depot doganore dhe 5 autorizime për procedurën e punimit të brendshëm. Vlera e taksave të pezulluar të cilat gjinden në depot doganore është 12 milion. Sa i përket pjesës së akcizës së brendshme të mbledhur kemi rritje të pijeve alkoolike krahasuar me vitin e kaluar. Te pjesa e pijeve joalkoolike po ashtu kemi ngritje të inkasimit të tatimit të akcizës. Kurse te akciza e lojërave të fatit kemi një rënie për arsye se shumica e aparateve janë larguar nga tregu dhe ka ra edhe shkalla e inkasimit të tatimit të akcizës. Për masat antikorrupsion brenda doganës në vitin e kaluar janë trajtuar 42 raste disiplinore dhe janë proceduar 80 oficer doganor për masa të ndryshme disiplinore, ndërsa 11 prej tyre janë në procedura hetimore në Prokurori. Brenda këtyre 80 zyrtarëve, Dogana ka shqyrtuar këto masa, 17 janë suspenduar, 3 janë të degraduar, 1 është i përjashtuar nga puna dhe 13 vërejtje me gojë, ndërsa janë bërë 23 vërejtje me shkrim, dhe 15 oficer Doganor i është ndaluar

promovimi. Sa i përket vitit 2015 i kemi 18 raste disiplinore ku janë të përfshirë 35 zyrtar, ndërsa në procedurë penale janë 2 raste duke u trajtuar bashkërisht me Prokurorinë që përfshihen 5 zyrtar Doganor.

Besa Gaxherri – bëri disa pyetje si në vijim: cili do të jetë ndikimi i pakos së re fiskale në Buxhetin e 2015 dhe planifikimin e Buxhetit të 2016 si dhe KASH 2016-2018? Cilat janë efektet në të hyrat, si rezultat i Vendimit të fundit të Qeverisë, për ndryshimin e normave të akcizës së duhanit, alkoolit dhe akcizës me ndryshim të limitit kohor në vjetërsinë e veturave? Në bazë të raportit tremujor 2015, të hyrat nga Doganat janë realizuar 17%. Sa është real plani i të hyrave dhe sa ka kapacitete Dogana e Kosovës për realizimin e tij në periudhën në vazhdim?

Lulzim Rafuna – theksoj që padyshim që ndryshimi i pakos së re fiskale do të ketë ndikim dhe ende jemi në fazën e analizave, te shkallëzimi i TVSH-së në disa kategori të mallrave për arsye se ne inkasojmë tatimin e vlerës së shtuar në emër të ATK-së. Sa i përket efektit të vendimit për ndryshimet e normave të akcizave sipas analizave efekti është i pritshëm që të jetë 14 milion, në rast se importohet sasia e mallrave e cila është importuar sipas historianit në vitin 2013. Mirëpo, jo gjithmonë importohet sasia e njëjtë, siç rasti për duhanin që ka ndodhur vitin e kaluar kur është ngrit akciza dhe kompanitë prodhuese për të mbajtur në treg çmimin stabil përveç që kanë ulur marzhën e kanë ulur edhe vlerën e mallit. Të njëjtin rast e kemi pas edhe te vajrat motorike siç janë benzina dhe nafta ku kemi pas ulje të çmimeve në bursat ndërkombëtare dhe automatikisht kemi pas ulje të inkasimit të normave të tatimit doganor dhe te TVSH-ja. Sa i përket projeksioneve e kam shpreh edhe te Ministri dhe janë shumë optimiste, për arsye se në vitin e kaluar kanë qenë 871 milion ndërsa për këtë vit është projektuar shuma prej 962 milion, dhe nëse e marrim parasysh trendin e zhvillimit ekonomik, investimet e huaja, shpenzimet kapitale, si Drejtor nuk më ipet një shpresë që të arrijmë deri në atë shumë. Mirëpo kësaj sipas trendit që kemi tani dhe përkundër rënies së sasisë së mallit ne kemi pritje që do të kalojë shuma prej 900 milion ose 910 milion euro në fund të vitit, që do të ishte një rritje prej 40 milion euro më shumë se në vitin e kaluar.

Bali Muharremaj - Si është bashkëpunimi i Doganës së Kosovës me institucionet tjera të nivelit qendror dhe lokal dhe cilat janë sfidat në këtë drejtim? Kosova ka nënshkruar një marrëveshje bilaterale për tregti të lirë si është rasti me Turqinë dhe në bazë të analizave të Doganës, cili do të jetë efekti i të hyrave doganore si rezultat i zbatimit të këtyre marrëveshjeve?

Lulzim Rafuna – bashkëpunimi me institucionet tjera është i shkëlqyeshëm. Me Policinë kemi bashkëpunim të ngushtë dhe kemi grupe të përbashkëta. Po ashtu me Administratën Tatimore janë bashkuar njësitë e hetimeve dhe rezultatet e para kanë dëshmuar qysh në raportet e vitit të kaluar. Ndërsa edhe me agjensionet tjera kemi bashkëpunim të mirë, por meqë jemi organ ekzekutiv, prej shumë agjensioneve presim që të marrim licencat dhe pëlqimet të cilat janë kompetent siç është Agjencioni i veterinarisë të ushqimit ku edhe me ta punojmë bashkë në të gjitha vendet kalimet doganore ose në zyre të brendshme doganore. Kemi bashkëpunim shumë të mirë edhe me Ministrin e Tregtisë dhe Industrisë i cili është organ vendimmarrës për shumë licenca sa i përket naftës dhe shumë produkteve tjera. Bashkëpunimi është i shkëlqyeshëm edhe me Agjencionin Kosovar të Inteligjencës e cila në mënyrë të rregullta na informon sipas informatave që posedojnë lidhur me kontrabandën dhe lidhur me mallrat e rrezikshme që hyjnë në Kosovë. Sa i përket marrëveshjeve me Turqinë sikurse që është edhe MSA-ja janë marrëveshje që parashohin eliminimin e tatimit doganor dhe ky eliminim doganor nuk parashihet që të këtë eliminim në tërësi, në ditën kur hyjnë në fuqi. Efekte janë asimetrike, shkon deri në 6 ose 7 vite duke i mbrojtë disa prodhimet tona. Ende jemi në pritje të analizave të Departamentit Makroekonomisë në MF, mirëpo pa dyshim që do të ketë ndikim në uljen ose eliminimin e tatimit Doganor.

Ilir Deda – ju theksuat së Dogana do ti mbledhë 40 milion euro më shumë si rezultat i luftimit të evazionit fiskal dhe kjo shifër më duket pak, sepse po del që luftimi i evazionit fiskal dhe informaliteti është i mangët. Edhe pse kjo nuk është vetëm punën e juaj, çka do të ndërmerret nga ana Doganës që të rritet efikasiteti i luftimit të evazionit fiskal dhe informalitetit? Sa i përket institucionit tuaj cilat janë sfidat më të mëdha në funksionim? Si rezultat i MSA-së e cila hynë në fuqi në vitin e ardhshëm parashihet të kemi rreth 200 milion euro më pak të hyra të mbledhura doganore, çka është duke u ndërmarr në këtë aspekt?

Lulzim Rafuna – sqaroi se në Dogana të hyrat nuk ndahen në mënyrë proporcionale, për shembull si 962 milion euro pjesëtuar për 12 muaj. Kjo varet nga vëllimi i importit edhe gjatë historianit prej vitit 1999 që kemi filluar funksionimin, gjithmonë në tremujorët e parë të vitit ka importe me nivel më të ulët për shkak festave dhe kohës dhe i mbledhim afër 25 ose 30 euro. Importi më i madh fillon prej muajit Prill e tutje, ndërsa në Gusht dhe Korrik i mbledhim afër 80 ose 90 milion euro. Sfidat më të mëdha për ne janë që ne edhe pse jemi duke funksionuar në veri jemi duke inkasuar detyrimet importuese doganore dhe sfidë do të jetë funksionalizimi ose vendosja e plotë në atë pjesë. Tani fatmirësisht edhe me KFOR-in kemi filluar me patrollu për gjatë vijës së gjelbërt, fal marrëveshjeve që janë lidhur në Bruksel. Ne kemi filluar me inkasue detyrimet importuese doganore dhe kemi bërë shtrirje të plotë në të gjithë territorin e Kosovës dhe e kemi nën kontroll të plot dhe nën mbikëqyrje, dhe fal këtyre angazhimeve kemi arritur që në çdo vit të kemi 40-50 milion euro më shumë të hyra. Sfidë tjetër do të jetë angazhimi i stafit në hulumtimin e vlerave, sepse te ne zakonisht risku më i madh është te vlera e mallit. Me vendet e rajonit kemi arritur që të kemi sistem dhe në kohë reale ti shkëmbejmë të dhënat për mallrat që importohen në vend. Kjo ka mundësuar që të luftojmë evazionin fiskal edhe me këto vende. Hapi tjetër i mirë që është bërë në këtë vit është vendosja e transitit të përbashkët me Shqipërinë ku prej Durrësit malli në Prishtinë vjen si me qenë një Doganë unike me një zyre të vetme dhe është shkurtuar koha prej dy ditëve sa është dashur me prit maunat, tani ajo procedurë kryhet për pesë minuta. Në dhjetë ditët e ardhshme ne do të bëjmë edhe një Doganë unike një zyre të vetme në dy pikat e kalimit. Kjo ka ngjall kureshtje edhe te vendet për rreth siç janë Mali i zi dhe Maqedonia. Sa i përket vlerës së mallit ne nuk i kemi ne 200 milion që i inkasojmë prej tatimit doganor, jo vetëm prej Evropës por prej të gjitha vendeve që importohet për arsye se e kemi fuqi CEFTA-n, dhe prej vendeve të rajonit ne nuk inkasojmë tatim doganor. Vetëm prej vendeve të BE-së shuma e përafërt e inkasimit të tatimit Doganor është rreth 50 milion. Edhe me MSA-në nuk parashihet që me 1 Janar të eliminohen këto 50 milion euro kjo është asimetrike e cila shkon deri 8 vite. Parashikimet e përafërta munden me qenë 7 deri 8 milion euro që nuk do të shkaktoj ndonjë zbrazëti të madhe në inkasimin e të hyrave.

Labinothë Demi-Murtezi – si është bashkëpunimi i Doganës me nivelin lokal të Qeverisjes? Sa i përket antikorupsionit më bëri përshtypje se është një person i përjashtuar nga puna, a ka mundësi që ne si komision të jemi të informuar për arsyen e shkarkimit nëse nuk ka qenë që nuk duhet të publikohet? Për ndryshe më intereson së çka nënkupton trajnimi i detyrueshëm për punëtorët e Doganës sepse keni 9 persona që gjatë vitit 2014 i keni dërguar në trajnim të detyrueshëm.

Lulzim Rafuna – një sfidë që po ballafaqohemi është numri i vogël i stafit të Doganës dhe kemi nevojë urgjente për 150 Doganier për shkak detyrave shtesë edhe nevojës që të kemi një angazhim më të madh. Sa i përket trajnimit të detyrueshëm në kohën e punësimit të oficerëve doganor i kemi ato trajnime të përgjithshme, sepse e kemi sistemin e rotacionit dhe transferojmë oficer doganor prej një pike në pikël dhe varësisht ku paraqitet nevoja atëherë kërkohet edhe të bëhen trajnimet. Sa i përket trajnimeve të detyrueshme, gjatë procedurave disiplinore në qoftë se komisioni disiplinor konstaton se oficerët doganor kanë nevojë për trajnime shtesë atëherë i obligojmë oficerët që të kenë trajnime të detyrueshme që të jetë në nivel të punës.

Fikrim Damka - a ka mundësi me na njoftuar se sa është numri i zyrtarëve në total që punojnë në Doganë?

Lulzim Rafuna – i kemi 565 oficer doganor, prej tyre 492 kanë statusin e oficerit doganor ndërsa 73 janë staf me status shërbyesi civil. Sa i përket etnicitetit sipas strukturës 88.85% janë Shqiptar, 4.07% janë Serb, 2.65% janë Turq, 2.48% janë Boshnjak, 1.42 % RAE, dhe 0.53% Goran.

Fikrim Damka – e kemi pas një mbledhje bashkë me Ministrinë e Financave në Prizren rreth importimit të arit për argjendarët dhe jemi dakorduar që të merren disa hapa konkrete në këtë drejtim. Kemi afër 526 Argjendar në Kosovë edhe gjithsej kanë importuar jo më pak se 1.5 kg ose 2kg Ari për një vit. Ku jemi me propozime dhe a janë përfunduar?

Lulzim Rafuna – Qeveria do ta merr një vendim ku do të ju njofton për këtë heqjen e tatimit doganor në ari sipas propozimit.

Bardhyl Meta – e kemi pas rastin e kompanisë Eurofol, si është vepruar me atë rast?

Lulzim Rafuna – personalisht edhe unë jam marrë me at rast edhe pse nuk merrem me raste konkrete mirëpo duke pas parasysh ka qenë edhe kërkesa e Odave dhe ka qenë edhe kërkesa e Ambasadës Gjermane dhe ne i kemi ofruar të gjitha mundësit. Ju njoftova edhe më herët se Dogana nuk duhet të jetë pengesë e të bërit biznes ne duhet të jem lehtësues i të bërit biznes. Dhe për këtë arsye ligji i kodit të Doganave dhe Akcizës na mundëson që deri në tri vite çdo lëndë të kthehet dhe të kontrollohet dhe rishqyrtohet. Mirëpo edhe kërkesën kur e dërgojmë për informata siç ka qenë rasti konkret në Doganën Gjermane jo gjithmonë ato vinë brenda 1 javës ato nuk mundën me zgjat 6 muaj deri në 1 vjet por edhe pas një viti varësisht qysh vjen kërkesa jonë në rend në Doganën homologe ku e bëjmë kërkesën. Te rasti i Eurofolit nuk është çështje që po zhvendoset në Maqedoni dhe asnjëherë nuk e kanë shpreh. Çështja është te borxhet është konstatuar një borxh pas të dhënave që kemi shkëmbyer me Doganën Gjermane është një borxh prej 100,000 euro ku pala nuk ka shpreh gatishmërinë që ta paguaj borxhin dhe ne jemi detyruar që palës ti ofrojmë 2 mundësi ose të hyjnë në marrëveshje siç e lejon edhe kodi Doganor i Akcizës që në periudhat e caktuara ta bëjnë pagesën e borxhit ose të shlyer borxhin në tërësi që të procedoj. Është paraqit dhe është në procedurë dhe do të shohim si do të vendosin palët dhe cili është opsioni më i favorshëm për palën.

Bardhyl Meta – për eksportimin e materialit, a është bërë zgjidhja me kodin?

Lulzim Rafuna – ne doganat kodet i kemi në gjuhë të bashkëpunimit dhe nuk lejohet një mall me dal prej një vendi, me një kod tjetër, ndërsa në vendin tonë me u paraqit një kod tjetër. Kodi është i unifikuar dhe atë kod që ne e kemi konstatuar e kanë konstatuar edhe Doganat Gjermane. Një problem tjetër që është paraqitur për ne dhe bizneset është mosfunksionimi i divizionit fiskal për ankesa dhe duhet me prit dy deri tri vjet deri sa të zgjidhet një ankesë. Sipas Kodit të Doganave dhe të Akcizës, është rasti vetëm, kur ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e vendimeve.

Kryetari – njoftoj se ky ishte një rast i mirë që ne të shprehim interesimet tona. Interesimi i jonë për mbështetje më të madhe institucionit të Doganave ka me qenë i shtuar në veçanti për plotësimin e nevojave në mënyrë që të jeni më efikas qoftë me staf profesional apo në avancimin e teknologjisë që konsideroj duhet të shtohet një kujdesi e veçantë në këtë drejtim. Krejt kjo në favor të inkasimit më të madh të të hyrave dhe të luftimit të informalitetit.

3.2. Takimi me Administratën Tatimore e Kosovës, në kuadër të procesit të monitorimit të realizimit të planit të të hyrave për tremujorin e parë të vitit 2015

Kryetari – njoftoj se ky është një fillim ndryshe në Parlament, që të kemi kontakte të drejtpërdrejta dhe po ashtu të informohemi nga dora e parë për rrjedhën e të hyrave, realizimin e planifikimeve, vështirësitë, ngecjet në realizimin e planeve dhe kërkesat. Është një rast i mirë për ti diskutuar ndryshimet që do të bëhen nga politikat fiskale dhe reflektimin e institucionit si barrësi kryesor i implementimeve.

Behxhet Haliti – gjatë kësaj periudhe tremujore ATK ka vazhduar trendin e punës bazuar në një plan operative detal dhe plan i trajtimit të rreziqeve dhe është shprehur në shifra. Gjatë periudhës tremujore ATK ka inkasuar mbi 12% më shumë se e njëjta periudhë në vitin e kaluar, ndërsa krahasuar me planin kemi një ngecje për - 5.3%. Gjatë kësaj periudhe ka zhvilluar edhe aktivitete tjera si puna në grupe punuese, me tri ligje bazike që lidhen me pakon fiskale. Është përmbyll sistemi i E-deklarimit me një përqindje 100% e filluar para tri viteve që është një prej sistemeve që është vlerësuar lartë por njëkohësisht ka rrit nivelin e kënaqshmërisë së tatimpaguesve. Në tre mujorin e këtij viti kemi arrit në 91% të të gjitha deklaratave dhe procesimeve në mënyrë automatike pa asnjë shpenzim për tatimpaguesit dhe me margjinë të gabimit zero. Kjo formë e deklarimit, ka ndikuar edhe në procesin e deklarimeve dhe inkasimeve e mjeteve për trustin pensional. Është përmbyll cikli i digjitalizimit të të gjitha shërbimeve të tatimpagueseve dhe njëkohësisht është punuar dhe është ngrit platforma për menaxhimin e riskut dhe për caktimin e kontroleve në mënyrë automatike duke i caktuar zyrtarët tatimor pa identifikuar menaxherët se kush me kënd ka me kontrolluar. Për periudhën tremujore janë inkasuar 84 milion euro në tatime dhe rreth 25 milion euro kontribute pensionale. Janë zhvilluar rreth 14,000 aktivitete që është e përshkruar me strategjinë e veprimit të ATK-së. Janë lëshuar rreth 2,182 gjoba mandatore dhe është trajtuar malli pa origjinë dhe po ashtu janë identifikuar 970 punëtorë të pa lajmëruar dhe fal këtyre aktiviteteve dhe zhvillimit të sistemit elektronik të viteve të fundit, mesatarisht kemi nga 10,000 të punësuar më shumë që paguajnë rregullisht kontribute dhe tatime në paga fal edhe E-deklarimit apo vërtetimit elektronik, që deri me tash vetëm për dy vite e kanë shfrytëzuar atë produkt rreth 46,000 zyrtar. Është ulur kreditimi dhe kemi zvogëlim të humbjeve. Kemi inkasuar rreth 9.2 milion euro në emër të borxheve. Ofrimi i shërbimeve ndaj tatimpaguesve është model për rajonin dhe kjo është vlerësuar nga të gjitha institucionet monitoruese në Bruksel apo në Uashington. Rreth 46,000 tatimpagues në kohë reale marrin çdo informacion që ju nevojitet për mes sistemit online të administratës së ATK-së. Një kohësisht edhe kontaktojnë zyret dhe shërbimet e edukimit tatimpaguesve dhe gjatë kësaj periudhe janë ofruar 88,328 shërbime për tatimpaguesit. Në fillim të vitit janë organizuar 9 seminare njoftuese në të gjitha qendrat e Kosovës ku kanë marr pjesë rreth 2,000 kontabilist dhe ekspert financiar. Janë regjistruar 45,816 tatimpagues dhe prej tyre nuk janë aktivë rreth 69,000 që përdorin sistemin elektronik online dhe kryesisht kemi të bëjmë me tatimpagues që kanë qarkullime mbi 5,000 euro. Janë publikuar shpjegime publike dhe njëkohësisht është vazhduar përpunimi me Ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, Agjencionin e regjistrimit të bizneseve për regjistrimin online dhe deri tani janë regjistruar 26,564 biznese. Tani jemi duke punuar në fazën përfundimtare për zëvendësimin e teknologjisë informative për informacion dhe kjo është një prej sfidave më të mëdha që ka ATK-ja për këto tri vitet e ardhshme në mënyrë që të përgatit këtë Agjencion drejt modernizimit.

Besa Gaxherri – që 15 vitet po mundohemi me ngrit sistemin e ATK-së dhe jemi në dijeni për punën e këtij institucion, mirëpo në teren nuk është gjendja e kënaqshme. Cilat masa janë ndërmarrë për reduktimin e ekonomisë joformale dhe evazionin fiskal, në fushën e Administratës Tatimore? Cilat masa i ka ndërmarrë ATK për të shmangur trendin e rritjes së borxhit në të ardhmen dhe reduktimin e nivelit aktual të borxhit dhe si ka ndikuar vendimi i Qeverisë për faljen e borxheve dhe si do të reflektohet kjo në Planin e ardhshëm Strategjik të ATK-së? Në raportin tremujor 2015, rimbursimet apo

kthimet nga ATK janë 6.94 milion euro apo 18% nga 38.81 milion euro të planifikuara. Cilat janë pengesat apo vështërsitë në rimbursim, kur dihet se kemi një shqetësim i madh të bizneseve lidhur me këtë çështje? Në raporti tremujor të buxhetit për vitin 2015, në bazë të të dhënave të prezantuara, të hyrat nga ATK janë realizuar 83.98 milion apo 20% e planifikimit. Sipas muajve, në janar janë inkasuar 40.95 milion euro, ndërsa në muajin shkurt dhe mars 21.16, respektivisht 21.87 milion euro, që tregojnë një trend të rënies së inkasimit sipas muajve. Në bazë të kësaj a do të realizohet planifikimi i paraparë për vitin 2015?

Behxhet Haliti – ATK për luftimin e ekonomisë joformale në mënyrë sistematike nga viti 2010 ka bazuar punën në dokumente strategjike. Në vitin 2009 është miratuar një plan strategjik 2010-2015 që tani është duke u miratuar plani për 2015-2020 sepse është përmbush plotësisht planifikimi. Ky është viti i katërt që punojmë sipas planit dhe kemi arritur që për çdo vit të kemi të hyra prej tre deri në pesë fish se sa është rritja e shkallës së GDP-së. Nuk mund të them se nuk ka ekonomi joformale mirëpo nëse krahasohemi edhe me regionin dhe më qasjen që ka si institucion ATK është vlerësuar se është në rrugën e mirë që ta trajtoj ekonominë joformale. Një konfirmim zyrtar që është raportuar në Uashington në dëgjimet vjetore është që ATK vetëm për dy vite ka ndikuar në zvogëlimin e hendekut tatimorë për 7.1%. Dhe nëse marrim statistikën për ekonomi joformale pajtohem që është rreth një e treta e ekonomisë joformale. Ekonomia joformale në 2008 ka qenë 51% deri 52% dhe po me të njëjtit parametra tash është rreth 32% deri në 34% dhe ku mesatarja botërore është rreth 20%. Në këtë plan që e kemi si Qeveri dhe si dy agjencione ne mendojmë që për tri vite ky boshllëk tatimor të vjen më ulët se 25% ku do të matet edhe efikasiteti i ATK-së. Nga hendeuku tatimor të matur rreth një e treta dihet që është te bujqësia dhe aty janë rreth 27,000 fermer që marrin subvencione nga Qeveria dhe asnjë nuk paguajnë tatim. ATK-ja ka trashëguar një barrë të madhe të borxhit nga periudha 2000-2008. Në nivel i lartë i akumulimit të borxheve që mban kohën e periudhës së rregulloreve të UNMIK-ut të cilat janë ngarkuar edhe bizneset me norme të interesit rreth 24% dhe ndëshkimeve 100%. Që nga viti 2012 kemi ndërtuar një sistem të brendshëm që përcjell rastin dhe zyrtarin, udhëheqësin dhe menaxherin. Nëse të dhënat zyrtare sillen që rritja ekonomike zyrtarisht është prej 2.8% deri në 3.2%, si administratë tatimore, zotohemi që çdo herë minimumi tre deri në pesë fish do të mbledhim të hyra dhe kjo do të thotë që ne e zvogëlojmë hendekun tatimor, sepse nuk mundemi me marr më shumë se që thotë ligji.

Ilir Deda - sa është shlyerja e borxheve në tri vitet e fundit, dhe jo në mënyrën se si po e paraqitni ju por në mënyrë reale? Arkat fiskale janë më të shtrenjtat për biznesin dhe bizneset e vogla nuk janë në gjendje me u pajisë me arka fiskale, çfarë po bëjnë institucionet përgjegjëse në këtë aspekt? Për mua është skandaloze ajo që thotë se arka fiskale kanë vetëm 1/3 e bizneseve, kur duhet të jetë qindpërqind? Pra, si është e mundur ne me i kreditue 27,000 njerëz dhe mos me iu marrë tatime, si rezultat i mos fiskalizimit. A është kjo për shkak të ndërhyrjeve politike apo dobësisë së sistemit? Projektioni për luftimin e informalitetit thotë se është rreth 34%, pse mos të zvogëlohet në tri vitet e ardhshme në 20%, a ka mundësi me tregu realitetin dhe nëse kjo mundet me u bërë, kush dhe çfarë duhet bërë për të arritur këtë qëllim?

Bexhet Haliti - nga të dhënat që i kemi rreth 27,000 janë fermer të regjistruar në ministrinë e bujqësisë, që kanë qenë pjesë e projekteve dhe subvencioneve. Për administratën tatimore shumë e përzemërsueshme në praktikë me e lëshue numër fiskal për çdo fermer, pastaj me e detyruar atë me pas një kontabilist e me e bërë deklaratën tatimore, në mënyrë që me përdorë sistemin elektronik. Në ligjet e reja që do të miratohen, në të cilat ka kontribuar ATK, do të këtë menaxhim më të mirë dhe do të vendosen instrumente që do të ndihmojnë edhe në luftimin e ekonomisë joformale. Sa i përket arkave fiskale, para një muaji, ministri i financave, ka bërë plotësimin dhe ndryshimin e udhëzimit administrativ, ku është bërë më atraktive hyrja e operatorëve të rinj dhe është bërë e mundur që tregu të ofrojë më shumë

pajisje. Në kuadër të kësaj ne kemi bërë përgatitjet edhe në inkurajimin e konsumatorëve për të mbledhur kuponat fiskal dhe pritjet e para i presim në korrik.

Enver Hoti - realisht ekonomia joformale apo mos tatimimi më i madh është në sektorin e industrisë. Jo nuk e potencuat farë këtë, e unë konsiderojë se jo formaliteti më i madh në ekonomi është pikërisht në këtë sektor. Ka mijëra punëtor që punojnë në të zezën dhe nuk i paraqesin fare, dhe nuk e di ka keni ndonjë statistikë apo ndonjë shifër, kur dihet se ka operator ekonomik që punojnë apo janë kontraktues të qeverisë në kryerjen e punëve në sektorin e ndërtimtarisë dhe punëtorët e këtyre kompanive nuk deklarohen dhe si rrjedhojë nuk tatimohen. Keni borxhlinj shumë të mëdhenj dhe këto rrinë në sirtarët e ATK-së. Qiradhënia po kushton me dhjetëra mira e nuk eksitojnë si të evidentuara. Ekonomia joformale është shumë e madhe në pjesën veriore të Mitrovicës sepse atje hyjnë dhjetëra mallra. Krahasset në nivelin botëror nuk është ndonjë shifër që mundemi me bë neve se mund të jetë edhe ndonjë shtet që nuk ka fare tatime.

Bexhet Haliti - me këtë qasje dhe me këtë mënyrë të trajtimit unë besojë fuqishëm se shkon drejtë uljes se ekonomisë joformale, sepse ne jemi mbi mesataren e shteteve në rajon. Sa i përket evazionit fiskal në Veri të Mitrovicës, ne bashkë me doganat, policinë, ne jemi duke e trajtuar në tri vitet e fundit dhe është duke u rritur normaliteti në atë pjesë. Sa i përket kontratave në operatorët ekonomik, ne kemi ngritur sistemet që 70% të kontrollave i kryen sistemi i kompjuterit. Kemi një kontroll të kualiteti nga zyra qendrore dhe e kemi një auditim të kontrollimit, por nuk përjashtojmë mundësinë e atyre rasteve, mirëpo sa të identifikohet merren masa të cilat janë të përcaktuar me ligj. Sa i përket qiradhënies, ata që e paraqesin si shpenzim qiranë në një farë mënyrë janë të detyruar të mbajnë 9% të vlerës së parasë që e paguajnë në çdo muaj.

Bali Muharremaj – sa i përket arkave fiskale, për bizneset e vogla dhe të mëdha shkojnë prej 270 deri në 700 euro, ndërsa kontributet janë 100 euro. Nëse e bëjmë krahasimin me veturat kur vlera e tyre në Kosovë është dikun 15,000 – 17,000 euro dhe kontrollimi teknik është 25 euro. Si ka mundësi në të ardhmen të reduktohet në më shumë kompani për çdo qendër komunale, pasi që kjo është monopol që shkojnë në gjepat e dy apo tre personave.

Bexheti Haliti - sa i përket fiskalizimit, në fund të muajit mars është miratuar udhëzimi ku është qartësuar edhe kontrolli teknik të arkave fiskale. Pajisjet elektronike fiskale është një çështje që është mediatizuar shumë, pikat e karburanteve janë subjekte që janë fiskalizuar të parat në 2008

Besa Gaxherri – sa përqind e bizneseve në Kosovë kanë arka fiskale?

Bexhet Haliti - rreth gjysma e atyre që kanë obligim për tu fiskalizuar kanë arka fiskale. Për tu pajisur me arka fiskale, kanë obligim vetëm ato të cilat marrin para kesh nga shërbimi dhe malli që ju ka dhënë dhe jo ato që bëjnë transaksione përmes xhirollogarive bankare.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Tatimin në të Ardhurat Personale

Agim Krasniqi - projektligji ka freskuar disa nga definicionet ekzistuese sepse ka pas dykuptimësi dhe paqartësi në vetë ligjin, është zgjeruar lista e të ardhurave duke përfshirë edhe dividendën, janë përfshirë edhe kategoritë tjera siç janë të ardhurat e personave me aftësi të kufizuar, të ardhurat me interes publik, kontributet nga punëdhënësi për shërim shëndetësor dhe për përfitimet e dëmshpërblimet në mes formës së prerë të gjykatave, si dhe kompensimet e caktuara që kanë të bëjnë me koston gjyqësore të të ardhurave në formë shpërblimit nga institucionet shtetërore për arritje shkencore, sport e kulturë, të ardhurat e përfituesve si rezultat i kompensimit financiar për të dënuarit politik dhe për kategorinë e ngjashme. Po ashtu edhe granatet dhe donacionet për tatimpaguesit, të ardhurat reale në

kushtet dhe të përfitimit. Në anën tjetër shpenzimet e reprezentacionit do të jenë të kufizuara në 1% e të ardhurave bruto si dhe shpenzimet e reklamës dhe promocionet tjera janë të zbritshme. Një tjetër element i rëndësishëm është lirimi për qëllime bamirësie që është e zbritshme në vlerën maksimale deri në 10%. Ky PL ka zgjeruar kategorinë e shpenzimeve të palejueshme, po ashtu është freskuar dhe zgjeruar lista e personave fizik, që janë të obliguar të mbajnë tatime në burim. Në bazë të vlerësimeve që i ka bërë ministria e financave, implementimi i këtij ligji, nuk sjell kosto shtesë financiare.

Pas sqarimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin për Tatimin në të Ardhurat e Personale.

5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave

Agim Krasniqi – me qëllim të adresimit të politikave të sistemit tatimore të të ardhurave të korporatave konform standardeve ka hartuar projektligjin e të ardhurave të korporatave. Elementet kryesore krahasuar me legjislacioni aktuale janë si vijon: një pjesë e konsiderueshme e definicioneve janë përmirësuar dhe janë eliminuar dykuptimësitë dhe kjo është harmonizuar me ligjin përkatës tatimor. Tatimi në korporata është përcaktuar 10%, prej kësaj kompanitë e sigurimit të licencuara për një kategori që i nënshtrohen normës tatimore prej 5% të primeve bruto të grumbulluara të periudhës tatimore. Ministër Financave ka kompetencë për përcaktimin e pushimit tatimore dhe lehtësirave të veçanta për bizneset e reja. Shpenzimet e trajnimit janë lejuar në limitin e përcaktuar me këtë projektligj. Kontributet e dhëna për qëllime bamirësie janë shpenzime të lejueshme deri në 10% të të ardhurave të tatueshme të llogaritura, kontribuuesit që kontribuojnë në fusha të caktuara do të ketë një lejim shtesë deri në 10% nëse parashihen me ligje të veçanta në Kosovë. Shpenzimet e reprezentacionit do të jenë të kufizuara në 1% e të ardhurave bruto si dhe shpenzimet e reklamës janë tërësisht të zbritshme. Për qëllimet e aktivitetit ekonomik për tatimpaguesit lejohet një zbritje e veçantë në 10% të çmimit të përvetësimit të pasurisë në vitin të cilin pasuria është vënë për herë të parë në shërbim. Në bazë të vlerësimeve të ministrisë së financave, zbatimi i projektligjit nuk sjell kosto shtesë financiare.

Safete Hadergjona - po shifet se tërë pakaja fiskale veç po fillon me disa ndryshime, për këto ndryshime po shifet se ka interesim nga jashtë Kuvendit nga palët të cilët në një farë mënyrë atakohen me këto ligje, dhe për neve është me rëndësi të gjejmë formën më të mirë gjatë amendamentimit të këtyre projektligjeve dhe njëkohësisht të shohim se çka po dojmë me arritur me këto projektligje. Nuk ka ndonjë pengesë me e kaluar procedurën e parë apo miratimin në parim, por ne duhet të konsultojmë grupet e interesit, të marrim mendimet dhe sugjerimet e deputetëve në Kuvend dhe po shpresojmë që të gjithë anëtarët kanë një interesim që këto ligje të dalin mirë.

Besa Gaxheri - pse në një nen të projektligjit është 10 % në korporata e për kompanitë e sigurimit të licencuara nga BQK-ja 5%, a mundeni me na shpjegue?

Agim Krasniqi – është e vërtetë se asnjë ligj nuk mundet me i kënaq të gjithë, ne po mundohemi me bënë funksion të zhvillimit ekonomik, ligje që realisht nuk i ngarkojmë shumë ato pjesë që kanë të bëjnë me problemet sociale dhe ne jemi të hapur edhe me i marrë sugjerimet e të tjerëve, por jemi munduar bashkërisht edhe me shoqërinë civile dhe me gjithë partnerët të tjerë para se me dorëzuar këtë projektligj në Kuvend. Kjo pjesa që përmendet ka të bëjë me kompanitë e sigurimeve që janë të licencuara nga BQK-ja e që i nënshtrohen normës tatimore 5%, për arsye se veprimtari e tyre është me specifike se e korporatave të tjera dhe asgjë tjetër nuk ka të bëjë me shumë të veçantë.

Kryetari - ne do të shikojmë të organizojmë edhe dëgjime me grupet e interesit lidhur me projektligjin e tatimit të korporatave edhe për TVSH-në.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave.

6. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2014

Kryetari - raporti është i mirë i hartuar dhe nuk ka pas mangësi apo tejkallime të shpenzimeve.

Lavdim Krasniqi - njoftoi se buxheti i ndarë për IGJK-në në vitin 2014, ka qenë fillimisht 652,922 euro, ndërkaq pas vendimeve të qeverisë, për shkurtime buxheti përfundimtar ka qenë 597,899.16 euro. Nga kjo shumë janë shpenzuar 587,438.80 euro apo 98.25%. Ne kemi dy burime kryesore e financimin e aktiviteteve tona. Burim kryesor është buxheti i Kosovës dhe burimi tjetër janë donacionet që kemi pasur ne vazhdimësi.

Kryetari – pyeti në shpenzime e buxhetit a përfshihen edhe rritja e pagave prej 25%?

Lavdim Krasniqi – sqaroi se në shpenzimet e buxhetit janë të përfshirë edhe rritja e pagave prej 25%. Kemi pas vështërsi në realizimin e programit të trajnimeve fillestare në tetor të vitit 2014, për shkak të shkurtimeve buxhetore por e kemi mbuluar me mbështete të donatorëve. Kryesisht trajnimet janë financuar nga buxheti i Kosovës dhe aktivitete tjera që lidhen me administratën. Ndërkaq aktivitetet tjera siç janë programet e shkëmbimit me jashtë janë realizuar me mbështetje të donatorëve. Kemi realizuar një reduktim të buxhetit për disa kategori, si të shpenzimet postare, karburantet për vetura, mirëmbajtjen e teknologjisë informative, shpenzimet e telefonave, etj. Disa tejkallime janë nënkategoritë si rezultat i afektimit të shkurtimeve buxhetore brenda institutit.

Ilir Deda - një këshill që kur të raportoni në vitet tjera, të keni parasysh për tejkallimin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime, dhe që për shpenzimet e përfaqësimit, të provoni të sjellin edhe pjesën profesionale këtë vit, që në vitin e ardhshëm të kemi përputhshmëri më të mirë.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2014.

Mbledhja përfundoi në ora 12:11

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani